

Raportimi financiar i OJF-ve

Në datën 17 prill 2015, me inisiativën e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit u organizua një tryezë e rrumbullakët ku të ftuar ishin palët e interesit, profesionistë të fushës, shoqatat profesionale dhe akademike, për të diskutuar mbi draftimin e një standardi të ri kombëtar të kontabilitetit mbi OJF-të. Përfundimet e arritura në këtë tryezë ishin si në vijim:

1. Të ruhet përkufizimi: OJF-të janë fondacione, shoqata dhe qendra. Të mos krijohet një tjetër përkufizim në standard.
2. Në standard të mos jepet asnjë listë orientuese për organizatat që mbulon ky standard.
3. Pasqyrat financiare të jenë të dedikuara për OJF-të.
4. Të ketë klasifikim të OJF-ve nga madhësia për qëllime të raportimit.